

SHOQËRIA TREGTARE ME ORTAKËRI ME PËRGJEGJËSI TË  
KUFIZUAR

**VUSHAJ CONSTRUCTION ALBANIA SH.P.K**

**AKT THEMELIMI**

Në Shkodër ,sot me datën 05/06/2023,(dymijë e njëzet e tre) ditë e Hënë,  
shtetasi me këtë identitet:

**Z. Alberto Vushaj** , atësia **Palo** ,e datëlindjes 27/11/1965, shtetas  
shqiptare , lindur në Tamare dhe banuese në St.Louis, Missouri ,USA  
identiteti i të cilit verifikohet me Pasaporten me numër 582412675 me  
afat deri më 03/05/2028 ,

krijoi:

**Shoqërinë Tregtare me ortakëri dhe me përgjegjësi të kufizuar**

**VUSHAJ CONSTRUCTION ALBANIA SH.P.K** ,Shkodër –  
Albania.

\*Vullnetin e tij të lirë , të plotë, të sigurtë dhe në iniciativën e lirë private

\*Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi.

\*Në ligjin Nr.9901 datë 14/04/2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë  
Tregtare”.

\*Në ligjin Nr .9723 datë 03/05/2007 “Për Qendrën Kombëtare të  
Rregjistrimit “



\*Në ligjin Nr.7764 datë 02/11/1993 "Për Investimet e Huaja "

dhe në të Drejtën Ndërkombëtare Publike dhe Konventat ndërkombëtare të gjithëpranuara të **Komunitetit Europian** ,me anën e këtij **Akti Themelimi** ,krijojmë **Shoqërinë tregtare me ortakëri** dhe me përgjegjësi të kufizuar

**VUSHAJ CONSTRUCTION ALBANIA SH.P.K**

### **NENI 1**

Krijohet Shoqëria tregtare me emrin **VUSHAJ CONSTRUCTION ALBANIA SH.P.K** emërtim i cili do të jetë i stampuar dhe në vulën e saj.

### **NENI 2**

**Selia Qëndrore** e Shoqërisë është në adresën: Shkodër ,Malesi e madhe Tamare, Fshati Selce, Ndertese Private me Nr. 6, Zona Kadastrale 3278.

### **NENI 3**

Shoqëria shtrin aktivitetin e saj tregtar në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë.

Me Vendim të Asamblesë së Ortakëve mund të krijohen ose anulohen (në rast se janë çelur ) **Seli, Filiale**, Agjensi dhe Përfaqësi si në qytete të tjera në Shqipëri ,apo në ndonjë shtet tjetër të huaj.

Njësitë e tjera strukturore të shoqërisë ,si degë apo përfaqësi dhe jashtë shtetit krijohen kur një gjë të tillë e parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i



vendeve të huaja , normat e së drejtës ndërkombëtare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

#### **NENI 4**

**Kapitali Themeltar** i Shoqërisë është në likuditet në shumën **1.000.000 Lekë** (një milion lek) i ndarë në **1 kuotë** te formuara dhe nënshkruar nga Ortakët sipas këtij kontributi:

- 1. Ortaku Z. Alberto Vushaj** kontribues me shumën **1.000.000 Lekë** e barabartë me **1 kuotë me të drejtë vendimore, e barabartë me 100 %**.

Ortaku ka pavarësi ligjore ,organizative si dhe të drejta pronësie mbi cdo lloj Kapitali, mjete xhiroje apo çdo lloj pasurie tjetër (të luajtshme apo të paluajtshme),të fituar në rrugë të ligjshme.

Shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj .

Ortaku ka të drejtë të transferojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pjesërisht ose tërësisht kontributet e tyre ,përfshirë fondet dhe vlerat e kontributit në natyrë bazuar në të drejtën që u njeh Ligji **“Për Investimet e Huaja”**.

**Shoqëria** dhe të tretët ,respektojnë këto transferime sapo tu bëhen të ditura.

#### **NENI 5**

Kapitali nuk mund të jetë kurrë i përfaqësuar me letra me vlerë .

#### **NENI 6**

Kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë është **PA AFAT** , duke filluar ky afat nga dita e rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit.





## **NENI 7**

Me vendim të Asamblesë së Ortakëve ,kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë mund të ndryshojë dhe ky vendim i dërgohet menjëherë për depozitim Qendrës kompetente për të bërë shënimet e nevojshme në Rregjistrin e Shoqërive Tregtare.

## **NENI 8**

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plotë me Legjislacionin shqiptar në fuqi si dhe mbi bazën e Kontratës së Themelimit dhe këtij Statuti të saj.

## **NENI 9**

**Shoqëria krijohet për të ushtruar aktivitetin e saj tregtar në këtë Drejtim:**

Donacione në fushën e ndërtimit ne shërbim të komunitetit, Aktivitet në fushën e ndërtimit.Ndërtime civile dhe industriale, restaurime dhe mirëmbajtje të pasurive te paluajtshme të marra nën kujdes,rrugë, autostrada, ura, hekurudha, etj. Rikonstruksione të objekteve sociale,kulturore,banesa etj.Prodhime te materialeve te ndërtimit etj..

## **NENI 10**

Me qëllim arritjen e objektivit të shoqërisë ,ajo ka të drejtë të merret me gjithçka që ka lidhje me objektin e saj , duke përmbushur të gjitha veprimet tregtare ,për pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme ,financiare e bankare , edhe me veprime të zbuluara (përjashtuar mbledhjen e fitimit ), duke pranuar pjesëmarrjen në fitim si dhe marrjen pjesë në shoqëri të tjera dhe



sipërmarrje me objekt veprimtarie analog,të ngjashme ose të lidhur me të , qofte direkt ,qoftë indirekt.

#### **NENI 11**

Shoqëria e fiton personalitetin juridik nga dita e pajisjes me Çertifikatën e Identifikimit të personit të Tatuashem (NIPT)nga Qendra Kombëtare e Rregjistrimit .

#### **NENI 12**

Me vendim të Asamblesë së Ortakëve ,në dispozicion të Shoqërisë mund të vihen fonde të tjera duke përfshirë dhe shtesa me anë të kapitalit në natyrë

#### **NENI 13**

Me Vendim të Asamblesë së Ortakëve ,Shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose më shumë ortakë të tjerë ,shtetas shqiptarë ose të huaj,ose të bashkohet me një Shoqëri tjetër tregtare si brenda vendit dhe jashtë vendit,të zgjerojë objektin e veprimtarisë së saj,të ndahet në mirëkuptim mes ortakëve ose në rrugë gjyqësore ,etj.

#### **NENI 14**

Organi më i lartë Drejtues Vendimor i Shoqërisë është Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve e cila ushtron të gjitha kompetencat që i njej **Ligji Nr.9901 datë 14/04/2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare "**

Ortakët mund të delegojnë kompetencat një ose më shumë Administratorëve të caktuar me vendim të Asamblesë së ortakëve ,si dhe



një personi juridik jashtë shoqërisë ,shtetas shqiptar ose i huaj mbi bazën e **Prokurës të bërë me akt notarial.**

#### **NENI 15**

Me vendim me shkrim të Asamblesë së **Ortakëve** caktohet ,shkarkohet **Administratori i Përgjithshëm** brenda ose jashtë bashkësisë së Ortakëve si dhe **Eksperti Kontabël i Autorizuar.**

#### **NENI 16**

**Administratori i Përgjithshëm** i Shoqërisë, emërohet **Z. Alberto Vushaj** atësia **Palo** ,e datëlindjes 27/11/1965, dhe

Bazuar në **nenin 95 të Ligjit Nr.9901 datë 14/04/2008** “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, **Administratori i Përgjithshëm Z. Alberto Vushaj** dhe emërohet për një **periudhe kohe 5 vjet**, me të drejtë ripërtëritje.

#### **NENI 17**

Detajimi në lidhje me problemet dhe administrimin e kapitalit themeltar dhe të pjesëve nominative të tij , Transferimi , Zmadhimi ose zvogëlimi i Kapitalit , mënyra e Drejtimit administrativ të Shoqërisë, ajo e mbajtjes së llogarive dhe të Bilancit financiar , zgjerimi i Shoqërisë ose shndërrimi i saj në një formë tjetër Shoqërie Tregtare , bashkimi me Shoqëri të tjera tregtare vendase apo të huaja , ndarja apo mënyrat e falimentimit të saj dhe kalimit në likuidim etj ,përcaktohen në mënyrë më të specifikuar në Statutin e Shoqërisë që i bashkëlidhet këtij Akti Themelimi .



## NENI 18

Si rregull dhe përgjithësisht Ortaku drejton dhe zhvillon aktivitetin tregtar të Shoqërisë mbi bazën e mirëkuptimit profesional dhe ligjor.

## NENI 19

Ky Akt Themelimi u redaktua në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe dhe me përmbajtje e vlera të njëjta juridike dhe pasi lexohet, kuptohet dhe miratohet në parim dhe nën për nen nga Ortaku themelues të **Shoqërisë tregtare**

**VUSHAJ CONSTRUCTION ALBANIA** SH.P.K dhe nënshkruhet prej tij në të gjithë kopjet duke u vënë, emri, mbiemri dhe firma origjinale, autenticiteti i të cilave vërtetohet dhe nga Noteri.

## ORTAKËT THEMELUES

TË SHOQËRISË TREGTARE ME ORTAKËRI

**VUSHAJ CONSTRUCTION ALBANIA**

SH.P.K

Miratues të këtij AKTI THEMELIMI

z. 